



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Nr. 4101 prot.

datë 13.8 2013

UDHËZIM

Nr. 38, datë 13.08.2013

“PËR

ARSIMIMIN E INDIVIDËVE TË MOSHËS SHKOLLORE
NË INSTITUCIONET E PERKUJDESJES SHOQERORE

Në mbështetje të nenit 57 dhe 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 18 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”,

UDHËZOJMË:

1. Individët, nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes shoqërore, arsimohen me kohë të plotë ose të pjesshme në shkollën më të afërt me institucionin përkujdesës ose në një shkollë të arsimit publik të caktuar nga DAR/ZA-ja përkatëse.
2. DAR/ZA-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social, identifikon fëmijët që janë përfitues të shërbimeve të institucioneve të përkujdesjes shoqërore.
3. Çdo institucion i përkujdesjes shoqërore, publik ose privat, është i detyruar të njoftojë DAR/ZA-në përkatëse për çdo përfitues të shërbimeve shoqërore që nuk ndjek arsimin e detyrueshëm dhe t'i përcjellë të dhënat e mëposhtme: a) emrin mbiemrin e përfituesit; b) emrin dhe vendndodhjen e institucionit të përkujdesjes shoqërore; c) adresën e banesës së përfituesit.
4. Kur përfituesi i përkujdesjes shoqërore është në moshën e detyrimit shkollor, DAR/ZA-ja cakton shkollën ku fëmija do të regjistrohet. Rregjistrimi mund të bëhet në çdo kohë.
5. Një komision, i ngritur nga drejtori i shkollës, përcakton klasën që fëmija duhet të ndjekë.

6. Kur përfituesi i përkujdesjes shoqërore nuk është në moshën e detyrimit shkollor, institucioni përkatës i përkujdesjes shoqërore dhe DAR/ZA-ja, bashkëpunojnë për ta regjistruar përfituesin në një shkollë të arsimit bazë me kohë të pjesshme.
7. Kur përfituesi e ndërpret ndjekjen e një klase, pajiset nga shkolla me një dëftesë të veçantë ku shënohen notat lëndore të klasës në vijim.

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR


MYQEREM TAJ

